

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**  
**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE**  
**KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Sherbimi i ngrohjes, per Spitalin Korce - Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj”.

Ne lidhje me faktin se kjo procedure nuk eshte ndare ne lote, kemi vepruar ne zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” konkretisht ne nenin 5 “**Kontratat e përziera**”, dhe nenin 6 “**Prokurim i përzier që mbulon disa veprimtari**” pika 1 dhe pika 3 germa a, e tij ku thuhet;

1. Për kontratat publike që kanë si objekt të tyre dy ose më shumë veprimtari, prokurimi i të cilave rregullohet në regjime të ndryshme, kur pjesë të ndryshme të saj janë objektivisht të ndashme, autoritetet ose entet kontraktore mund të zgjedhin të japin disa kontrata të ndara për secilën prej tyre **ose të japin një kontratë të vetme, kur për arsye objektive, është i pamundur prokurimi në kontrata të ndara.** Në çdo rast, zgjedhja midis prokurimit të një kontrate të vetme dhe prokurimit të disa kontratave të ndara nuk duhet të bëhet me qëllimin për ta përjashtuar kontratën ose kontratat nga fusha e zbatimit të këtij ligji.

3. Kur autoritetet ose entet kontraktore zgjedhin të japin një kontratë të vetme, për dhënien e kontratës do të zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) në rastin e kontratave, të cilat kanë si objekt prokurimin që mbullohet nga sektori klasik dhe prokurimin për kryerjen e një veprimtarie sektoriale, rregullat e zbatueshme përcaktohen sipas dispozitave që rregullojnë sektorin klasik;

Nisur nga sa më sipër, njesia e prokurimit ka vepruar ne zbatim te ligjit dhe rregullave te prokurimit publik, duke u ndodhur perballe faktit ligjor qe per kete procedure prokurimi **për arsye objektive, është i pamundur prokurimi në kontrata të ndara,** pasi deshtimi i njerit lot do te shkaktonte deshtimin edhe te lotit tjetër dhe te komplet procedures ne rastin e prokurimit me lote, pra dy veprimtarite qe prokurohen ne kete procedure prokurimi mund te konsiderohen si nje dhe objektivisht te pamundura per tu ndare.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** 71314310-8  
Sherbime per ngrohje te ndertesave.

**VLERA E FONDIT LIMIT:** Vlera e pritshme e kontratave qe mund te lidhen per periudhen 12 mujore – **21,616,985.84** (njëzet e një milion e gjashtëqind gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë pikë tetëdhjetë katër) Lekë pa TVSH, ose **25,940,383.01** (njëzet e pesë milion e nëntëqind e dyzet mijë e treqind e tetëdhjetë e tre pikë zero një ) leke me TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korce, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

##### **2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:**

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015/ekuivalente (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 9001:2015)
- b) Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015/ekuivalente (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 14001-2015.

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

**Argumentim:** *Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 8 gërma “a” - “b” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

**ISO 9001:2015** është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do

të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

**ISO 14001:2015** ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

**ISO-t e kerkuara si me siper** Duhet te jete e operatorit ekonomik pjesmarres dhe nuk merret me bashkim operatoresh apo marreveshje bashkepunimi me mbeshtetje kapacitetesh ne subjekte te tjera.

Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 8 gërma “a”- “b”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës.

Organi i vlerësimit të konformitetit të çertifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues duhet të jetë i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për të vërtetuar këtë kriter duhet të paraqitet akreditimi i entit çertifikues që ka lëshuar çertifikat ISO të paraqitura.

**2.1.2** Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të jenë të pajisur me licensë lëshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (*GRUMBULLIM, RUAJTJE DHE TRANSPORTIMI I LËNDËVE TË DRURIT DJEGËSE URBANE (PELLET)*), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.

**Licensa III.2.B:** Duhet te jete e operatorit ekonomik pjesmarres dhe nuk merret me bashkim operatoresh apo marreveshje bashkepunimi me mbeshtetje kapacitetesh ne subjekte te tjera.

**Argumentimi :** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”.*

*Në shtojcën 1/B eshte listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.*

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën **për transportin e mbetjeve**, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë certifikatat ISO dhe licensat të kërkuara janë të detyrueshme për secilin operator ekonomik, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të **3 (tri) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023)** të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

*Shënim:* Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (e ndryshuar)”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr.10091 date 05.03.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar).

**2.2.2** Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë **3 (tri) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023)** lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël 40% se vleres se fondit limit. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

Fondi limit është **21,616,985.84** leke pa TVSH,

**40% e 21,616,985.84 = 8,646,794 leke pa TVSH.**

Pra vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar (2021-2022-2023) duhet të jetë jo më e vogël se **8,646,794** leke pa TVSH.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore argumenton vlerën e kërkuar të xhiros.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar **Ligji Nr . 9920, datë 19.5.2008 Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqiperise i ndryshuar, Ligji Nr.8438, datë 28.12.1998 Per tatimkin mbi te ardhurat si dhe Udhëzimi Nr.5, datë 30.01.2006 Per Tatimin mbi te ardhurat i ndryshuar pika 3.12 “Deklarimi tatimor dhe Llogaritja perfundimtare e detyrimit”.** (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor per vitin 2024 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar), sipas adresave të regjistruar sipas QKB. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar) si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar).

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës të fondit limit per te cilin konkuron.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të

plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Fondi limit është **21,616,985.84** leke pa TVSH,

**40% e 21,616,985.84 = 8,646,794 leke pa TVSH.**

Pra vlera për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, të jetë në një vlerë jo më të vogël se **8,646,794** leke pa TVSH.

**2.3.2** Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 9) konkretisht:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi/cope	Statusi
1	Kamion me kapacitet mbi 10 ton	copë	1	Në pronësi/me qera

**Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 9 Shtojca të DST.**

- a. Për mjetet në pronësi, duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit: (akti i pronësisë; b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm);
- b. Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm);  
Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes/ dokumentacione të tjera provuese të pronësisë/ si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- c. Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përlllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe asetëve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

**2.3.3** Operatori ekonomik në rastin kur nuk është prodhues i lëndës djegëse pellet, duhet të paraqesë kontrata furnizimi materiale me prodhues të lëndës djegëse pellet, ose **edhe kontrata me distributor të autorizuar nga prodhuesi**. Pra AK lejon mundësinë që ofertuesi të paraqesë kontratat furnizimi edhe nga distributori i autorizuar nga prodhuesi. Ofertuesi duhet të vërtetojë lidhjen e distributorit me prodhuesin.

Gjithashtu për rastet kur OE nuk është prodhues, duhet të paraqesë një vetëdeklarim që furnizuesi është konform standardeve të cilësisë, dhe AK ka të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, si dhe në rastin kur OE shpallet fitues, AK të kërkojë paraqitjen e certifikatave të kërkuara.

*(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).*

**Argumentim:** Në bazë të nenit të 70, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion kerkesat për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

## **2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.4.1** Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korce, me qëllim sigurimin e ngrohjes në ambientet e Spitalit Korce (ambiente të cilat janë 36,481 (tridhjetë e gjashtë mijë e katerqind e tetëdhjetë e një metra kub), operatori ekonomik duhet të ketë në pronesi ose me kontratë qeraje **5 (pese) copë kaldaja me pellet** dhe një bucatore me pellet.

**2.4.2** Kaldajat duhet të jene të pajisura me shnek dhe të shoqeruara me certifikatat perkatese.

**2.4.3** Për pajisjet teknike në pronësi, (kaldajat, djegësi/bruciatori sillozi dhe shnekët) operatori ekonomik duhet të paraqesë akt çdoganimi ose kontratë shitblerje noteriale, si edhe dokumentacione të tjera provuese si dhe forma të tjera të pronësisë.

**2.4.4** Për pajisjet teknike të marra me qera (kaldajat, djegësi/bruciatori, sillozi dhe shnekët), duhet të paraqitet kontratë qeraje noteriale e shoqëruar me dokumentin e pronësisë së qiradhënësit. Kontrata e qeraje duhet të jete e vlefshme për periudhën e mbulimit të shërbimit.

**2.4.5** Kaldajat duhet të jene të pajisura me certifikate konformiteti të Inspektimit të Pajisjeve nën presion me vatra zjarri.

**2.4.6** Operatori ekonomik i shpallur fitues me një deklaratë nga ana e tij, të marrë përsipër të beje montimin me shpenzimet e veta të pajisjeve djegese të pelletit si dhe mirembajtjen e tyre po me shpenzimet e veta, nga data e fillimit të kontratës deri në perfundimin e saj, si dhe trajnimin e personelit spitalor që do të punoje në këto kaldaja. menjëherë mbas marrjes së njoftimit nga Autoriteti Kontraktor, por jo me vonë se data e çeljes së sezonit të ngrohjes.

**2.4.7** Ofertuesi, me një deklaratë nga ana e tij, të marrë përsipër riparimin e kaldajave dhe djegësit ( bruciatorit ) në rast të ndonjë defekti të mundëshëm gjatë periudhës së zbatimit të kontratës.

**2.4.8** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë raportet e testimit ose fletë analizat nga laboratorë të akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë për lëndën djegese pellet, objekt prokurimi me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike dhe standarteve të kërkuara. Dëshmia me rezultatet e testeve zyrtare duhet të jetë lëshuar brenda Vitit 2024.

*Shënim: Dokumentacioni për akreditimin e laboratorit i cili ka lëshuar fletë analizat e kërkuara do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

*(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kriteret e tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërish çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).*

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, dhe 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike.**

Te sigurojë ngrohje të gjithë ambienteve të kërkuara nga AK, çdo ditë për 24 orë, për 152 ditë. Periudha e realizimit të shërbimit do të jetë 15 tetor 2024 – 31 Dhjetor 2024 dhe 01 Janar 2025 – 15 Mars 2025.

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Sasia e diteve të punës
1	Qira Kaldajat dhe bruciatori	cope	5 (pese) kaldaja dhe 1(nje) brucator	152

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Pellet (per 152 dite)	Kg	330,000

Drejtorja e Shërbimit Spitalor Korce, me qëllim sigurimin e ngrohjes në ambientet e Spitalit Korce (ambiente të cilat janë 36,481 (tridhjetë e gjashtë mijë e katerqind e tetëdhjetë e një metra kub), operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me kontratë qeraje 5 (pese) copë kaldaja me pellet dhe një bucatore me pellet.



Kaldajat do te instalohen si me poshte :

- Tek Korpusi kryesor Spitali Korce, do te instalohen dy cope kaldaja, 1(nje) kaldaje me fuqi jo me pak se 500 kw, dhe 1 (nje) kaldaje me fuqi jo me pak se 250 kw, qe do te ngrohin nje siperfaqe prej 11,706 (njembdhjete mije e shtateqind e gjashte), meter kub.

Kaldaja me fuqi jo me pak se 500 kw qe duhet te plotesoje minimalisht te dhenat si me poshte;

- o Fuqia min/max e punes jo me pak se 392 - 530 kw
- o Fuqia termike nominale jo me pak se 500 kw
- o Fuqia termike e kthyer jo me pak se 459 kw
- o Tensioni i punes (elektrik) jo me pak se 380 v
- o Fuqia motorrike jo me pak se 1100 W
- o Rendimenti jo me pak se 87 %
- o Presioni i ujit jo me pak se 1,5 - 3,8 bar
- o Kapaciteti i ditor i silozit jo me pak se 1,5 m<sup>3</sup>

Kaldaja me fuqi jo me pak se 250 kw qe duhet te plotesoje minimalisht te dhenat si me poshte ;

- o Fuqia min/max e punes jo me pak se 200 – 250 kw
- o Fuqia termike nominale jo me pak se 250 kw
- o Fuqia termike e kthyer jo me pak se 220 kw
- o tensioni i punes (elektrik) jo me pak se 380 v
- o Fuqia motorrike jo me pak se 1100 W
- o Rendimenti jo me pak se 87 %
- o Presioni i ujit jo me pak se 1,5 – 3,8 bar
- o Kapaciteti i ditor i silozit jo me pak se 1,5 m<sup>3</sup>

Tek pediatria e Spitalit Korce do te instalohen dy kaldaja. Nje me fuqi nje jo me pak se 500 kw, qe do te ngrohe ambjentet e godines se Pediatrise dhe e dyta me fuqi jo me pak se 250 kw, qe do te ngrohe godinen e maternitetit, te dy kaldajat se bashku do te ngrohin nje siperfaqe prej 15,015 (pesembdhjete mije e pesembdhjete) metra kub.

Kaldaja me fuqi jo me pak se 500 kw qe duhet te plotesoje minimalisht te dhenat si me poshte;

- o Fuqia min/max e punes jo me pak se 392 - 530 kw
- o Fuqia termike nominale jo me pak se 500 kw
- o Fuqia termike e kthyer jo me pak se 459 kw
- o tensioni i punes (elektrik) jo me pak se 380 v
- o Fuqia motorrike jo me pak se 1100 W
- o Rendimenti jo me pak se 87 %
- o Presioni i ujit jo me pak se 1,5 - 3,8 bar
- o Kapaciteti i ditor i silozit jo me pak se 1,5 m<sup>3</sup>

Kaldaja me fuqi jo me pak se 250 kw qe duhet te plotesoje minimalisht te dhenat si me poshte ;

- o Fuqia min/max e punes jo me pak se 200 – 250 kw
- o Fuqia termike nominale jo me pak se 250 kw
- o Fuqia termike e kthyer jo me pak se 220 kw
- o tensioni i punes (elektrik) jo me pak se 380 v
- o Fuqia motorrike jo me pak se 1100 W
- o Rendimenti jo me pak se 87 %
- o Presioni i ujit jo me pak se 1,5 – 3,8 bar
- o Kapaciteti i ditor i silozit jo me pak se 1,5 m<sup>3</sup>

- Tek Senatoriumi i Spitalit Korce do te instalohet nje kaldaje me fuqi jo me pak se 250 kw qe do te ngrohe nje sipërfaqe prej 1600 (njemije e gjashteqind) metra kub.

Kaldaja me fuqi jo me pak se 250 kw qe duhet te plotesoje minimalisht te dhenat si me poshte ;

- o Fuqia min/max e punes jo me pak se 200 – 280 Kw
- o Fuqia termike nominale jo me pak se 250 kw
- o Fuqia termike e kthyer jo me pak se 220 kw
- o tensioni i punes (elektrik) jo me pak se 380 v
- o Fuqia motorrike jo me pak se 1100 W
- o Rendimenti jo me pak se 87 %
- o Presioni i ujit jo me pak se 1,5 – 3.8 bar
- o Kapaciteti i ditor i silozit jo me pak se 1,5 m3

Brucatori do te instalohet tek Poliklinika e Spitalit Korce, sipërfaqja e poliklinikes eshte 8,160 (tete mije e njeqind e gjashtedhete) metra kub,

Brucatori duhet te plotesoje minimalisht karakteristikat teknike si me poshte:

- o fuqia min/max ne kw jo me pak se 400-550 kw
- o tensioni i punes (elektrik) jo me pak se 220 V
- o fuqia e motorit te ventilatorit jo me pak se 190 W
- o Kandelet e ndezjes 2 cope jo me pak se 750 W
- o Rendimenti jo me pak se 85 %
- o fuqia e motorit te shnekut jo me pak se 180 W
- o dimensionit tubit te shkarkimit jo me pak se 75 mm

**Te dhenat teknike te pellet druri te jene si me poshte;**

Parametra	Rezultati
Fuqia kalorifike	<=4.4 Mcal/kg
Gjatesia	20-40 mm
Diameter	6 mm
Lageshtira	4-8%
Mbetja e hirit	<0.7
Paketimi	10-20 kg

### **Shënim:**

- 1- Çmimi i pelletit të kete të përlogaritur të gjitha detyrimet ligjore deri në dorëzimin e tij në magazinat e Spitalit Korçë.
- 2- Cdo furnizim duhet te shoqerohet me certifikaten e cilesise, te peletit sipas kriterëve te percakuar nga ana e Autoritetit Kontraktor.
- 3- Çmimi i pelletit te kete te perlogaritur te gjitha detyrimet ligjore deri ne dorezimin e tij ne magazinat e Spitalit Korce.
- 4- Kapaciteti maksimal i nje furnizimi eshte **165,000 kg pellet**.
- 5- Lenda djegese e kerkuar per furnizim do te levrohen nga kontraktuesi sipas kerkesave te Autoritetit Kontraktor.

- 6- Kontraktuesi duhet te siguroje furnizim te vazhdueshem per 24 ore ne dite dhe sipas cilesise se kerkuar.
- 7- Furnizimi me pellet nga ana e subjektit kontraktues do te behet prej ores 08:00 deri ne oren 16:00, nga dita e hene ne te premte.

### **Shënim për operatorët ekonomik:**

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”,* si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Gjithashtu risjellim ne vemendje se:

- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 9 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit permbushes per keto pika do te jete kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht skualifikimi.
- KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit si dhe rezervon te drejten e verifikimit ne terren lidhur me funksionimin e proceseve te punes per pajisjet që do të paraqiten nga operatorët ekonomik. .
- Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

### **Njësia e Prokurimit**

- |           |            |                                  |
|-----------|------------|----------------------------------|
| 1. Bledar | HOXHALLARI | anetar (Pergjegjes i prokurimit) |
| 2. Edmond | RËMAÇKA    | anetar (Specialist i fushes)     |
| 3. Entela | MADHI      | anetare                          |